

RELACION TEKNIK

Projekti: Pulari per rritjen e zogjve te pules e pulave.

Sipas Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"; Shtojca I, klasifikohet si aktivitet që i nënshtrohet procedurës së thelluar të Ndikimit në Mjedis.

*Klasifikohet në: Shtojca I, 17. Instalime për mbarështimin intensiv të pulave ose derrave me mbi:
a) 1000 krere pulat që rriten për mish*



Subjekti: Eros Driza, P/F, Nipt: M22520405N, Fier, Fshati Mbrostar Ura

Relacion i hartuar nga:

Ekspert i licensuar

Ing. Gjergji Selfo

PERMBAJTJA E LENDES

Raporti teknik eshte hartuar ne baze te kerkesave ligjore te meposhteme:

• *Referuar VKM Nr 828 date 28.12.2023, per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore" Kreu II.*

• *Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"; Shtoja I, klasifikohet si aktivitet që i nënshtrohet Procedures se thelluar te Ndikimit ne Mjedis. Specifikisht klasifikohet ne: Shtojca I, pika 17. Instalime për mbarështimin intensiv të pulave ose derrave me mbi: a) 1000 krere per pulat qe rriten per mish*

Sipas kerkesave ligjore te mesiperme raporti teknik permban:

a) qellimi i projektit te propozuar	4
b) planimetria e vendndodhjes se projektit, ku pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes, te shoqeruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ Gauss Kruger, fotografi dhe te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti, gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise;	5
c) informacionin per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendndodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti;	9
ç) skicat dhe planimetritet e objekteve dhe strukturave te projektit si dhe menytrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve dhe strukturave te projektit;	16
d) pershkrimin e proceseve ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese / perpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit;	20
dh) informacionin per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, fumizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja;	24
e) programin per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatjen e planifikuar per funksionimin e projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe, sipas rastit, edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes, pas mbarimit te funksionimit te projektit;	29

ë) lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji);	32
f) informacionin per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones se projektit;	34
g) informacionin per altemativat e marra ne konsiderate, per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret;	34
gj) te dhenat per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshem, te energjise, lendeve djegese dhe rnenyren e sigurimit te tyre;	35
h) aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertimi i kampeve apo rezidencave etj.;	36
i) informacionin per lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme per projektin, ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin, autorizimin, licencimin e projektit;	36
j) kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar, ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin, autorizimin, licencimin e projektit.	36

a) qellimi i projektit te propozuar

Ky relacion eshte hartuar per projektin "Pulari per rritjen e zogjve te pules e pulave", ne fshatin Mbrostar Ura ne Fier. Objekti ne fjale do te sherbeje vetem per rritjen e shpendeve, ata do te merren te vegjel (zogj) dhe do te rriten ne objekt deri ne fazen e pergatitjes se tyre per dergimin ne thertoreve te ndryshme te per mish sipas kerkesave te tregut. Ky projekt mendohet te kete nje impakt pozitiv ne treg duke bere te mundur nje punesim te perhershem apo edhe te perkohshem te zonave perreth fshatit ku ndoshet aktiviteti.

Zona ne te cilen eshte projektuar objekti ndodhet ne fshatin Mrostar Ura, Bashkia Fier. Ajo pozicionohet pergjate nje rruge rurale qe sherben per nevojat e fermereve dhe bizneseve te zones. Prona ka nje sipërfaqe totale disponibel prej 10352 m². Kjo zone i perket sistemit bujqesor. Zona eshte e mireformuar me infrastrukture te plote rrugore, te rrjetit ujesjelles, kanalizimeve, elektrikut dhe telefonise. Kjo zone eshte nje zone e pasur me toka bujqesore, Ajo eshte ne nje pozicion te favorshem per tu shfrytezuar per bujqesi e blegtori. Te gjithë zonat/fshatrat rreth Mbrostarit jane zona ku rralle gjenden toka te paperdorura, ndaj dhe z. Eros Driza ka menduar zhvillimin e prones se tij per ngritjen e nje objekti 1 kat per rritjen e zogjve deri ne nje peshe te caktuar dhe per ti derguar me pas ne thertore (tjertorja nuk eshte pjese e ketij projekti) nga ku do te tregetohen per mish. Eshte menduar instalimi i nje kapaciteti prej rreth 50 000 zogj qe rriten per mish.

b) planimetria e vendndodhjes se projektit, ku pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes, te shoqeruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ Gauss Kruger, fotografi dhe te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti, gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise;

Te dhenat e tokes ne pronesi:

Z. K. Nr. 2636, Nr. i Pasurise 44/5, **Siperfaqe Totale 10352 m2.**




Gjatesia e parceles: 180 metra

Gjeresia e parceles: 58 metra

Koordinatat e parceles Gauss – Kruger Zone 4

Pika	E	N
1	4382327.13	4515591.25
2	4382362.64	4515634.95
3	4382205.56	4515736.87
4	4382175.59	4515686.80








c) informacionin per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendndodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti;

Vendodhja e aktivitetit



Territori ne studim ku do realizohet projekti nuk eshte i perfshire ne zone buferike, te cilat ruhen ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe as ne ndonje zone me vlera turistike apo zone te mbrojtur sic shihet edhe me siper, ku distancat e prones sone nga zonat e mbrojtura sipas legjislacionit ne fuqi po i paraqesim me poshte:

- 18 Km nga Zona e Mbrojtur Divjake-Karavasta;
- 16 Km nga Pishe Poro;
- 18 Km nga bregdeti Seman;
- 22 Km distance nga Vjose-Narte;
- 19 km nga rrënojat e qytetit antik te Apollonisë;
- 7 Km nga qendra e Fierit;
- 2 km nga qendra e fshatit Mbrostar;

Pra sic duket edhe me siper nga distancat e paraqitura duhet te themi se prona jone ne studim nuk do


te kete asnje efekt negative ne zonat me rendesi te vecante.

Zona ne te cilen eshte projektuar objekti ndodhet ne nje zone fushore. Nuk ka qendra te banuara aty prane. Qendra e banuar me e afert eshte fshati Mbrostar. Aktiviteti pozicionohet pergjate nje rruge rurale qe sherben per nevojat e fermerëve dhe bizneseve te zones.

Prona ka nje siperfaqe totale disponibel prej 3500 m². Sipas Planit te Pergjithshem Vendor te miratuar me vendim te KKTse Nr.4, Dt. 10/06/2020, kjo zone i perket sistemit bujqesor.

Zona eshte e mireformuar me infrastrukture te plote rrugore, te rrjetit ujesjelles, kanalizimeve, dhe elektrikut.

Gjatë projektimit të këtij objekti janë marrë parasysh të gjitha rregullat urbane të përcaktuara në VKM` në 408, duke respektuar të gjitha parametrat urban dhe duke mos cënuar privatësinë e komunitetit të kësaj zone.



Distancat nga fshatrat me te afert jane:

- 7.5 km nga qendra e fshatit Suk1;
- 2 km nga qendra e fshatit Mbrostar;
- 5.1 km nga qendra e fshatit Kolonjë;
- 5.2 km nga qendra e fshatit Bubullime;
- 5.3 km nga qendra e fshatit Beline;

Qendrat me te medha te banuara pervec fshatit Mbrostar jane, qyteti i Fierit dhe Roskoveci.

Fieri është një nga qytetet kryesore dhe të rëndësishme të Shqipërisë. Për herë të parë emri i Fierit ndeshet në dokumentet osmane të vitit 1737. Atëherë quhej Fierza dhe nuk ishte tjetër veçse një fshat i vogël me disa shtëpi të vogla. E diskutueshme ka mbetur edhe origjina e emrit Fier për të cilin sot ekzistojnë dy hipoteza. E para është ajo e studiuesit Hysen Emiri, i cili mendon se emri Fier rrjedh nga italishtja "Fiera", që do të thotë panair. Sipas tij, këtë emër ja vendosën këtij vendi tregtarët venedikas që merreshin me blerjen e produkteve bujqësore-blegtorale në panairin që zhvillohej pranë kishës së Shën Gjergjit, ndoshta që nga koha e Mesjetës, kohë prej nga ka nisur të përdoret ky emërtim. Hipoteza e dytë mbi origjinën e emrit Fier është ajo e studiuesit Toli Shabani. Ai thekson se ky emër ka origjinë bimore, pra vjen nga bima e fierit. Pika më e fortë e kësaj teze është se, në të gjithë zonën e Myzeqesë së Vogël mbizotërojnë toponimet me origjinë bimore si: Sheq, Marinas, Marinëz, Frashër, Sheqishtë, Qarr, Pishë, Fikth, Kallam, Shkozë, Drizë, etj.

Përsa i përket qytetit të Fierit popullsia e tij pas viteve '90 të shekullit të XX numëronte 40 000 banorë, kurse në ditët e sotme, si rezultat i dyndjes së popullsisë nga rrethi i Mallakastrës dhe nga rrethet veriore të vendit, vlerësohet që popullsia e qytetit të Fierit të ketë arritur në 122 000 banorë[1]. Ndërsa e qarkut 302 mije banorë[2]. Fieri është një nga qytetet me te zhvilluara.

12 km larg qytetit të Fierit, ndodhen rrënojat e qytetit antik të Apollonisë. Qyteti u themelua në vitin 558 p.e.s në një kodër pranë detit dhe afër grykëderdhjes së lumit Aoos (Vjosa) nga kolone të ardhur nga Korinti e Korfuzi. Në lulëzimin e tij mendohet të këtë pasur një popullsi prej 50 000 - 60 000 banorësh. Për rëndësinë ekonomike dhe kulturore dhe për hapësirën e madhe të shtrirjes së tij, Ciceroni e ka quajtur qytet të madh dhe hijerëndë.

Në vitin 1769 Fieri ishte një fshat me rreth 24 shtëpi prej balte dhe qerpiçi të ndërhuara myzeqarët dhe voskopojarët që sapo ishin ngulur në Fier dhe rrethinat përreth. Qyteti modern i Fierit u themelua më 1864 nga Kahraman Pashë Vrioni dhe djali i tij, Omer Pashë Vrioni, të cilët me ndihmën e urbanistëve dhe arkitektëve francezë hodhën themelet e qytetit modern të Fierit. Fizionominë e këtij plani, qyteti i Fierit e ruan edhe sot ku ndërthuren dy sisteme; ai kuadratik dhe rrezor. Në fund të shekullit të XIX Fieri kishte 4 lagje: Shkozë, Belik, Kishë dhe Pasha. Në librin e saj Brenga e Ballkanit udhëtarja angleze Edit Durham kur shkruan për Fierin e vitit 1904, tregon se në të janë ngritur godina prej guri me arkitekturë çuditërisht moderne.

Monumentet më të rëndësishme arkeologjike janë: muri rrethues, biblioteka, Odeoni, Portiku dhe Kisha Bizantine e shekullit të XIII. Kërkimet e para mbi thesarin historik të Apolonisë u bënë gjatë Luftës së Parë Botërore nga arkeologët austriak, që zbuluan dhe eksploruan muret e mëdha që rrethonin qytetin e dikurshëm. Zbulimet sistematike filluan në vitin 1924 nga Misioni Arkeologjik Francez drejtuar nga Leon Rey. Ata nxorën në dritë kompleksin e monumenteve të qendrës së qytetit. Zbulimet kanë vazhduar nga arkeologët shqiptarë pas çlirimit.

Qendra të tjera të popullimit parahistorik në rrethin e Fierit kanë qenë edhe Stefanafana, Nemfeumis, kështjella Argyas, Kolkondasi, Cakrani, Margellici, Portëza, Petova etj.

Regjistrimi i parë i popullsisë është ai i vitit 1923 ku Fieri ishte nënprefekturë nënvarësinë e Beratit. Në përbërjen e Fierit futeshin 2 krahina: rrethi Fier me 71 fshatra, 2193 shtëpi dhe 12.760 banorë, krahina e Semanit me 22 fshatra, 305 shtëpi dhe 1940 banorë. Vete qyteti i Fierit kishte 5 lagje dhe 1493 banorë.

Gjatë fillimit të shekullit të XX-të deri në vitet e Luftës së Dytë Botërore në Fier ndodhën mjaft ndryshime demografike. Aty u vendosën banorë të ardhur nga Labëria, Çamëria dhe Kosova si dhe grupe të ndryshme popullatash të ardhur nga Toskëria si nga Mallakastra, Berati, Gjirokastra etj. Ndërsa pas Luftës në qytetin e Fierit u vendos një numër i madh çamësh të dëbuar nga Greqia.

Ne vitin 1958 sipas ndarjes së re administrative rrethi kishte një sipërfaqe prej 1175 km². Në të bënin pjesë 4 qytete si dhe 139 fshatra të grupuar dhe 21 të bashkuar. Me shndërrimin e rrethit në qendrën ekonomike me të zhvilluar pas kryeqytetit, ndodhi një proces i zhvilluar urbanizimi. Për të plotësuar nevojat e industrisë dhe bujqësisë, filloi një lëvizje e madhe migratore drejt Fierit. Në vitin 1965 qyteti i Fierit numëronte 20 000 banorë, kurse në 1982 kishte 35 000 banorë. Në vitin 1985, Fieri si rreth kishte një popullsi prej 226.200 banorë, dhe dendësi 192 b/km². Popullsia qytetare arrinte shifrën 27.6 % ndërsa ajo fshatare 72,4 %. Rritja natyrore ishte 2,09 %.

Me fillimin e viteve 90-të në Fier ndodhën mjaft ndryshime demografike. Një pjesë e madhe e banorëve kanë emigruar drejt shteteve të huaja dhe kryeqytetit si dhe kanë ardhur banorë nga rrethet e Mallakastrës, Tepelenës, Beratit, Elbasanit, Gjirokastrës si dhe nga zonat veriore e verilindore të Shqipërisë. Në vitin 2001 popullsia e rrethit të Fierit ishte 199.082 banorë. Ndërsa qyteti i Fierit ka një popullsi 82.262 banorë. Dendësia e popullsisë për rrethin e Fierit 255 banorë/km², një nga më të lartat në Shqipëri. Mosha mesatare e popullsisë është 38 vjeç.

Roskoveci dhe zona përreth, është një qendër e banuar e hershme. Fakti që ndodhet ndërmjet dy qyteteve të hershëm, atij të Beratit dhe Bylisit, tregon që kjo trevë i përket një qytetërimi të hershëm. Siç dihet në afërsi të Roskovecit, ka qenë një nga kishat më të vjetra në Shqipëri, bëhet fjalë për kishën e Kurjanit. Nga dokumentet të studiuesve të huaj, një nga degëzimet e rrugës Egnatia, ka qenë me pike fundore pikërisht në këtë zonë. Kjo shpjegon faktin tjetër të lindjes dhe funksionimit të njërit prej pazareve më të mëdhenj në vend, ai i quajtur Pazarit i Roskovecit, i cili shërbente jo vetëm për tregtimin e mallrave të gjithë zonës deri në thellësi të Skraparit, Beratit, Tepelenës etj. Mendohet gjithashtu, që në këtë pazar bëhej tregtia më e madhe e gurëve të çmuar dhe e materialeve prej argjendi në kohën e Perandorisë Osmane. Ky qytet ka gjithashtu një klimë shumë të mirë për zhvillimin e kulturave bujqësore e blegtorale. Roskoveci është shquar për rritjen e prodhimin e mishit të dërrit. Roskoveci dhe zona përreth ka qenë qendër e banuar e hershme si një vendbanim i ndodhur ndërmjet dy prej qyteteve që i përkasin qytetërimit të lashtë (Berat dhe Bylis), si dhe pikë fundore e një prej degëzimeve të rrugës Egnatia.

Territori në studim nuk është e përfshirë në mënyrë të drejtperdrejte në zone të mbrojtur si:

- Rezerve strikte natyrore \ rezervat shkencor \ (Kategoria I);
- Park kombëtar (Kategoria II);
- Monument natyror (Kategoria III);
- Rezervat natyror i menaxhuar \ zone e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV);
- Peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- Zone e mbrojtur e burimeve të menaxhuara \ zone e mbrojtur me përdorim të shumefishtë (Kat VI).

Me poshte ju paraqesim hartën e zonave të mbrojtura, ku duket qartë largësia që ato kanë nga prona në studim.



Harta e zonave të mbrojtura

Territori në studim ku do realizohet projekti nuk është i përfshirë në zone buferike, të cilat ruhen në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe as në ndonjë zone me vlerë turistike apo zone të mbrojtura siç shihet edhe me sipër, ku distancat e prona sone nga zonat e mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi po i paraqesim me poshtë:

- 35 Km nga Zona e Mbrojtur Divjake-Karavasta;
- 35 Km nga Pishë Poro;
- 33 Km nga bregdeti Seman;
- 33 Km distance nga Vjose-Nartë;
- 23 km nga rrënojat e qytetit antik të Apollonisë;
- 18 Km nga qendra e Fierit;

- 600 m nga qendra e fshatit Kurjan;

Pra sic duket edhe me siper nga distancat e paraqitura duhet te themi se prona jone ne studim nuk do te kete asnje efekt negative ne zonat me rendesi te vecante.

Aktiviteti zhvillohet ne fushe, larg qendrave te banuara. Aktiviteti me i afert eshte nje mobilieri rreth 200 metra larg dhe nje servis automjetesh bujqesore.



Qendra e banuar me e afert eshte fshati Mbrostar



ç) skicat dhe planimetrite e objekteve dhe strukturave te projektit si dhe menytrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve dhe strukturave te projektit;




PLANIMETRI E MAGAZINES&NYJES SE MAKINERIVE TE BLUARJES "NJESI PRODHIMI SHPENDESH ERDS FARM"

SUBJEKTI "ERDS DRIZA" P.FIZIK NIPT M22520405N

ADRESA: FIER ,URA MBROSTAR,FSHATI MBROSTAR,Z.KAD.2636,NR.PAS. 44/5

MAGAZINA E PRODUKTIT FINAL DHE LINJA/NYJA MAKINERIVE TE BLUARJES USHQIMIT SHPENDEVE



Zona ne te cilen eshte projektuar objekti ndodhet ne afersi te fshatit Mbrostar, Bashkia Fier. Ajo pozicionohet pergjate nje rruge rurale qe sherben per nevojat e fermereve dhe bizneseve te zones. Prona ka nje siperfaqe totale disponibel prej 10352 m². Sipas Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Fier, kjo zone i perket sistemit bujqesor. Zona eshte e mireformuar me infrastrukture te plote rrugore, te rrjetit ujesjelles, kanalizimeve, elektrikut dhe telefonise. Kjo zone eshte nje zone e pasur me toka bujqesore pasi eshte ne nje pozicion te favorshem per tu shfrytezuar per bujqesi e blegtori. Te gjithë zonat/fshatrat perreth jane zona ku rralle gjenden toka te paperdorshme, ndaj dhe subjekti ka menduar zhvillimin e prones se tij per ngritjen e nje objekti 1 kat per rritjen e zogjve deri ne nje peshe te caktuar dhe per ti derguar me pas ne thertore (tjertorja nuk eshte pjese e ketij projekti) nga ku do te tregetohen per mish. Eshte menduar instalimi i nje kapaciteti prej rreth 50 000 zogj qe rriten per mish.

Respektivisht per projektin "Ferme per rritjen e shpendeve 1-kat" me nje siperfaqe te shfrytezueshme toke prej 2300 m² Magazina qe do te ndertohet do te kete nje siperfaqe prej 120 m² dhe me nje lartesi te shfrytezueshme 6.5 m. Objekti eshte projektuar per te pasur nje ambient higjenik dhe lehtesisht te pastrueshem per te parandaluar ndotjen e objektit ne teresi por edhe per qarkullimin e lirshem brenda tij per levizjen e punonjesve. Kjo redukton rrezikun nga ndotja dhe ul mundesine e aksidenteve midis punetoreve te cilet mund te perplasen duke levizur gjate procesit. Per te gjitha fazat e procesit eshte siguruar hapësira e nevojshme e funksionimit.

Ne fazen e projektimit jane marre parasysh te gjithë elementet e nevojshem per hartimin e nje projekti sipas kuadrit ligjor dhe kerkesave te investitorit per ndertimin e nje objekti sipas projektit qe ai ka menduar te ndertoje duke parashikuar te gjitha kushtet sipas standarteve dhe hapësiren e nevojshme qe do ti duhet ketij objekti pas perfundimit te procesit te ndertimit.

Eshte dizenuar duke pasur parasysh gjeometrine dhe parametrat e hapësirave te prodhimit.

- Mbulimi do te jete me ngjyre te bardhe te lehte per te reflektuar nje perqindje te madhe te energjise diellore duke cuar ne reduktim te konsumit energjistik dhe kontroll te temperaturave te brendshme. Kjo ngre rendimentin ne pune.

- Ne paretet anesore do te vendosen dritare ventiluese per te krijuar qarkullimin natyral te ajrit, nese do te jete e nevojshme eshte menduar edhe vendosja e disa ventilatoreve tavanore per te ndihmuar qarkullimin.

- Do te perdoren sisteme dhe pajisje qe kursejne energji aty ku eshte e mundur vendosja e tyre

Ambjenti eshte projektuar:

- Bazuar ne nevojat aktuale dhe te mevonshme.

- Per lehtesimin e cfaredo lloji ndryshimi ne biznes/zgjerim aktiviteti apo sasi stafi/zyra apo hapësira te tjera brenda godines.

- I adaptueshem edhe ne rastet kur funksioni ndryshon teresisht.

- Qe hapësira e jashtme te plotesoje nevojat per qarkullimin e lirshem te mjeteve te furnizimit si dhe per parkim te perkohshem te tyre.

- Me strukture tavanore me rezerve strukturne per perballimin e shtesave te mevonshme te pajisjeve apo ngarkesave.

- Me sistem mbrojtjeje kunder zjarrit i nevojshem per sigurine e materialeve me rrezik te larte ndezjeje.

- Per maksimizim te perdorimit te hapësires se brendshme duke siguruar edhe hapësire qarkulluese per personelin (dhe pirunin ngrites).

- Per arritshmeri te mire te portave komunikuese per ngarkim-shkarkimin e mallit si dhe ne zonen e manovrimit te kamioneve.

- Dhe llogaritur per mbulim dhe veshje anesore kundrejt efekteve natyrale si shiu, era apo lekundjet sizmike.

- Qe te kete nje dyshemeje rezistente ndaj gerryerjes, rreshkitjes dhe peshave te renda duke dhene pjerresite e duhura per mbledhjen e ujit.

- Qe niveli i dyshemese te jete 15cm mbi nivelin e sheshit dhe lidhjen e krijojme me rampa te pershtatshme per levizje te panderprere nga brenda jashte dhe anasjelltas.

- Dimensionet e dyerve jane 180cm x 220cm ne 550cm x 400cm per te siguruar funksionim te plote pajisjeve shkarkuese/ngarkuese.

Kapanonet

Me nje siperfaqe te shfrytezueshme prej 2300 m2 dhe me nje lartesi te shfrytezueshme 5.5m total, objekti eshte projektuar per te pasur nje ambient higjenik dhe lehtesisht te pastrueshem.

Brenda ndertesës produkti leviz hap pas hapi ne nje proces te vazhduar linear. Kjo redukton rrezikun nga ndotja dhe ul mundesine e aksidenteve midis punetoreve te cilet mund te perplasen duke levizur gjate procesit. Per te gjitha fazat e procesit eshte siguruar hapësira e nevojshme e funksionimit.

Tarraca

Mbulimi i ndërtesës nga sipër do bëhet me panel termoizolues me vlezime, trashësia e të cilit do të jetë 40 mm. Vendoset me një pjerresi 8% duke sjelle ujerat në jug ku do vendoset ulluku horizontal e me pas ata vertikale.

Veshja anësore e ndërtesës do bëhet pjesërisht me mur të vazhuar perimetral betonarme deri në lartësi 40 cm nga niveli 0 për të krijuar një mbrojtje nga proceset e punës dhe goditjet. Kolonat metalike IPE 240 do të jenë në pjesën e brendshme të perimetrit veshes. Me pas vendoset konstruksioni metalik I mbajtjes (arkarexhat) së paneleve sanduiç termoizolues me vide të fshehur, trashësia e të cilit do të jetë 40 mm.

Teknologjia e montimit të tyre nuk lejon të cara apo diferenca të cilat ndikojnë në termoizolim dhe në futjen e insekteve.

Dyshemeja do të realizohet me beton të markës së lartë me finitura të lemuara pa carje dhe demtime të sipërfaqjes. Cilesia e betonit lidhet me peshën të cilës duhet të rezistojë kurse cilesia e finiturave lidhet me kujdesin ndaj acideve apo lendeve gerryerese të cilat me kalimin e kohës depozitohen nëpër të cara dhe krijojnë erozion.

Mendohet që të përdoret Epoxy për lyerjen e dyshemeve, është rezistent ndaj substancave gerryese, trafikut të rëndë dhe pastrohet lehtë.

Për të lehtësuar pastrimin me ujë të rrjedhshëm dyshemeja do të marrë pjerresitë e nevojshme për të drejtuar ujerat në kanalet drenuese të cilat do të mbulojnë me rrjeta metalike lehtësisht të levizshme në rastet e mirmbajtjeve apo avarie.


Panelet janë të lyera me bojë me rezistencë të lartë e cila ndihmon pastrimin e shpejtë dhe larjen me ujë të rrjedhshëm në rastet e ndotjeve.

Ndricimi ditor, si ndricim i orëve me të ngarkuara të punës, sigurohet me anë të dritareve duke bërë njëkohësisht edhe ventilimin e hapësirës në rastet e motit të nxehtë. Kjo ul edhe konsumin e energjisë elektrike duke bërë sa më rentabel stabilimentin. Të gjitha dritaret pajisen me rrjeta mbrojtëse insektesh dhe parvazet e tyre kanë një pjerresi të konsiderueshme për të mos lejuar akumulimin e pluhurave.

Kompleksi është menduar të funksionojë si një hapësirë e kontrolluar nga një portë komunikuese nga rruga rurale që ndodhet në lindje të pronës. Ambjenti do të rrethohet gardh mbrojtës metalik me lartësi H-2m.

Hapësira është organizuar me godinën kryesore që vendoset në mes të pronës për të krijuar hapësirë parkimi/sherbimi përpara dhe pas si dhe hapësirë sherbimi dhe të gjelber në perimetër. Për shkak të pjerresisë së terrenit do të bëhet tarracimi në pjesën ku do të vendoset objekti dhe sherbimet e jashtme. Shtrimi i sheshit do të bëhet me beton.

d) pershkrimin e proceseve ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese / perpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit;




Zona ne te cilen eshte projektuar objekti ndodhet ne afersi te fshatit Mbrostar, Bashkia Fier. Ajo pozicionohet pergjate nje rruge rurale qe sherben per nevojat e fermereve dhe bizneseve te zones. Prona ka nje siperfaqe totale disponibel prej 10352 m². Sipas Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Fier, kjo zone i perket sistemit bujqesor. Zona eshte e mireformuar me infrastrukture te plote rrugore, te rrjetit ujesjelles, kanalizimeve, elektrikut dhe telefonise. Kjo zone eshte nje zone e pasur me toka bujqesore pasi eshte ne nje pozicion te favorshem per tu shfrytezuar per bujqesi e blegtori. Te gjitha zonat/fshatrat perreth jane zona ku rralle gjenden toka te paperdorshme, ndaj dhe subjekti ka menduar zhvillimin e prones se tij per ngritjen e nje objekti 1 kat per rritjen e zogjve deri ne nje peshe te caktuar dhe per ti derguar me pas ne thertore (tjertorja nuk eshte pjese e ketij projekti) nga ku do te tregetohen per mish. Eshte menduar instalimi i nje kapaciteti prej rreth 50 000 zogj qe rriten per mish.

Lende te para qe do te perdoren per procesin e ndertimit te ketij objekti jane materiale ndertimi te thjeshte me vlere te njohura te cilat nuk kane efekte negative ne mjedis si hekur, beton, panel sandwich i cili do te sherbeje per veshjen e mbulimin e objektit etj. Te gjitha materialet mendohet te blihen ne qytetin e Fierit ose perreth zones ne studim duke shmangur keshtu transportin e materialeve por edhe kostot, pasi aty kemi te gjitha firmat dhe minimizim te kostos se transportit per materialet e nevojshme te ndertimit por ne kete menyre minimizojme dhe efektet negative ne mjedis te cilat vijne nga transporti.

Mbulimi do te jete me ngjyre te bardhe te lehte per te reflektuar nje perqindje te madhe te energjise diellore duke cuar ne reduktim te konsumit energjitik dhe kontroll te temperaturave te brendshme. Kjo ngre rendimentin ne pune. Ne paretet anesore do te vendosen dritare ventiluese per te krijuar qarkullimin natyral te ajrit, nese do te jete e nevojshme eshte menduar edhe vendosja e disa ventilatoreve tavanore per te ndihmuar qarkullimin. Do te perdoren sisteme dhe pajisje qe kursejne energji aty ku eshte e mundur vendosja e tyre. Ambjenti eshte projektuar:

- Bazuar ne nevojat aktuale dhe te mevonshme.
- Per lehtesimin e cfaredo lloji ndryshimi ne biznes/zgjerim aktiviteti apo sasi stafi/zyra apo hapësira te tjera brenda godines.
- I adaptueshem edhe ne rastet kur funksioni ndryshon teresisht.
- Qe hapësira e jashtme te plotesoje nevojat per qarkullimin e lirshem te mjeteve te furnizimit si dhe per parkim te perkohshem te tyre.
- Me strukture tavanore me rezerve strukture per perballimin e shtesave te mevonshme te pajisjeve apo ngarkesave.
